




Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, më përjashtim të nenit 5 të kësaj rregullore përkatësisht nenit 5 pika 2.4 e saj që ka të bëjë me lokalet në pronësi të komunës, për të cilat duhet të zhvillohen proceduarat e konkurrimit përmes ankandit publik ashtu siç përcaktohen më Legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale .

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za:	Gazmend Muhaxheri, gradonačelnik opštine Peć Islam Husaj, predsedavajući Skupštine opštine Peć	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik ministra i ministar MLS-a Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS.	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MLS	Datum, 20.01.2021 br. 463-27
Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Sanije Derguti, viša službenica za monitorisanje opština/	
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Peć	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-05 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:


Uredba br. 03/2020 o određivanju postupaka o davanju na korišćenje nepokretne imovine opštine manje od godinu dana
Usvojena dana, 28.12.2020. godine,
Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 05.01.2021. godine,

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi sa izuzetkom člana 5. ove uredbe, odnosno člana 5. tačka 2.4 koji ima veze sa prostorijama u vlasništvu opštine, za koje se konkursni postupci moraju razviti putem javne licitacije kako je definisano važećim zakonodavstvom o davanju na korišćenje i razmenu opštinske imovine.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 01-109206, datë: 28.Dhjetor 2020 .

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), e në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10/2019"), e konform nenit 7 të Rregullores Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 7, pika 1.2, nenit 13 pika 1.3, dhe nenit 20 pika 1.3. të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431, të datës 30. Shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës me datën 28.12.2020 pas procedurës së diskutimit publik, miratoi këtë:

RREGULLORE

Nr. 03/2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen, kriteret kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për periudhën më pak se një vit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Pejës.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Neni 4
Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

I.Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrë që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit.

2. Pronat e paluajtshme të komunës të cilat mund të jepen në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë:

2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese);

2.2 Shtëpitë e kulturës; kinematë, teatrot dhe terrenet rekreative-sportive;

2.3 Hapësirat publike para lokaleve;

2.4 Lokalet në pronësi të komunës;

2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

Neni 6

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

- 1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;
- 1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
- 1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;
- 1.4 Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
- 1.5 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
- 1.6 Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik;
- 1.7 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;
- 1.8 Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore-sportiv e të ngjajshme.

Neni 7

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
 - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike, kërkesa i drejtohet drejtorisë së Urbanizmit;
 - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim për objektet kulturore, rinore dhe sportive, kërkesa i drejtohet drejtorisë për kulturë, rinë dhe sport ;
 - 2.3. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të komunës, kërkesa i drejtohet drejtorisë përkatëse për pronë ;
 - 2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet drejtorisë për shërbimeve publike;

3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar.

Neni 8 **Kushtet për aplikim**

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
 - 1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik ;
 - 1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik ;
 - 1.4. Historiati i biznesit që aplikon ;
 - 1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 - 1.6. Projekti ideor ;
 - 1.7. Vërtetimi nga komunat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse .

Neni 9 **Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile**

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

Neni 10 **Formimi dhe përbërja e komisionit**

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj rregullorja ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.

2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa dy anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.
3. Komisioni ka për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese
5. Mandati i komisionit do të jetë dy (2) vite .

Neni 11 E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave ;
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej pesë (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në komunë.
5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës;
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të inicojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave do të jete dy (2) vite.

Neni 12 Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 13
Nënshkrimi i kontratës

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit e pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 14
Mbikëqyrja e kontratës

1. Drejtoria përkatëse bën mbikëqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatisë raport përfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgatitur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një(1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 15
Mirëmbajtja e pronës së komunës

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrë të caktuar konform kontratës për shfrytëzim;
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Pejës, të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 17
Konflikti me ligjin

1. Në rastë konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18
Zbatimi

1. Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Pejës.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1 Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Pejës, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", dhe nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores-Nr-01/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Dr. Islam Husaj

Data _____
SHTOJCA 1

LOGOJA

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit ____ të Statutit të Komunës së _____, 01. nr. 110 – _____, të dt. _____, e ne mbështetje të nenit 10 të Rregullores (_____) nr. /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M PËRFORMIMIN E KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, me këtë përbërje:
 - 1.1 _____ Kryesues/e;
 - 1.2 _____ Anëtar/e;
 - 1.3 _____ Anëtar/e;
2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform kësaj rregulloreje për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe t'i rekomandojnë Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e kontratës.
3. Mandati i komisionit është dy (2) vite
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës _____

SHTOJCA 2

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit ____ të Statutit të Komunës së _____, 01. nr. 110 – _____, të dt. _____, e në mbështetje të nenit 10 të Rregullore (_____) nr. /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Formohet komisionit për shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrihen kundër vendimit të vlerësimit të kërkesave nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim në këtë përberje;

- 1.1 _____ Kryesues/e;
- 1.2 _____ Anëtar/e;
- 1.3 _____ Anëtar/e;
- 1.4 _____ Anëtar/e;
- 1.5 _____ Anëtar/e;

3. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit për shqyrtimin e ankesave është që të vendos lidhur me ankesat e cila parashtrihen kundër procesit të vlerësimit të kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

4. Mandati i Komisionit është dy (2) vite;

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

SHTOJCA 3

Në mbështetje të nenit -----, pika ----, lidhur me nenin ---, të Rregullores Nr.(-----), për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim për më pak se një (1) të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Raportit final të komisionit 01-Nr-----, i datës ----- për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës së ----- lidhë këtë:

K O N T R A T Ë

Për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës së -----

E hartuar me datën ----- në -----, e lidhur në mesë palëve kontaktuese, si më poshtë:

I. PALËT KONTRAKTUESE:

1. Kryetari i Komunës i cili e përfaqëson Komunën -----, si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë dhe

2. z. ----- nga lagjia/ fshati ----- Komuna e -----, me numër personal të letërnjoftimit -----, përfitues-shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, të pronës së paluajtshme të Komunës së -----, parcela kadastrale Nr.-----, sipas certifikatës së pronës nr.-----, datës -----, zona kadastrale "-----", vendi i quajtur "-----", e evidentuar pronë e Kuvendit Komunal-----, me sipërfaqe të përgjithshme-----m², për shfrytëzim me karakter ----- sipas kërkesës së prezantuar nga pala.

Neni 2

Kohëzgjatja e kontratës

- 1 Palët kontraktuese janë pajtuar që afati i shfrytëzimit së parcelës të lartcekur të jetë ----- ditë/ muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës 01-Nr-----, të datës -----.
- 2 Pas kalimit të afatit të paraparë në pikën 1, të nenit 2, të kësaj kontrate ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet pronarit Komunës së -----;

Neni 3

Lartësia e çmimit dhe afati i pagesës

1. Çmimi për periudhën ditore/mujore është caktuar në vlerë prej 0.00€ për m², që është e përcaktuar sipas rregullores për taksa të komunës me numër të protokollit 01-Nr----- të datës -----.
2. Shfrytëzuesi obligohet që pagesën në ----- të marrë në shfrytëzim të paguaj në xhirollogarinë ----- e Komunës së -----, në fillim të çdo muaji, duke filluar prej ----- më së largu deri më ----- të muajt vijues.
3. Në rast të mos pagesës së borgjit, ndaj shfrytëzuesit do të merren masa ndëshkimore, sipas procedurave ligjore në fuqi, duke e llogaritur edhe kamatën.
4. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë nga qiramarrësi.

Neni 4

Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

1. Komuna garanton se objekti i kësaj kontrate nuk ka të meta juridike.
2. Komuna është e detyruar që pronën e dhënë në shfrytëzim, ta evidentoj në librat kadastrale të drejtën e shfrytëzimit për atë kohë sa zgjat afati i kësaj kontrate.
3. Shfrytëzuesi nuk mund t'a ndryshojë ushtrimin e veprimtarisë së vet, por pronën që e ka marrë në shfrytëzim duhet ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin e kërkuar ashtu si që e ka të paraparë më këtë kontratë.

Neni 5

Mbikëqyrja e kontratës

1. Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi i Komunës së ----- dhe si e tillë ajo nuk mund t'i bartet personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
2. Drejtoria përkatëse mbikëqyrë realizimin e kësaj kontrate.

Neni 6

Shkëputja e njëanshme e kontratës

1. Shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme bëhet në rast të mospërbushjes së obligimeve, nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në këtë kontratë.

2. Në rast të shkëputjes së kontratës para kalimit të afatit, me marrëveshjen e palëve kontraktuese, obligimet e mbetura do të rregullohen me marrëveshje të veçantë mes palëve kontraktuese, por duke e lajmëruar njëra-tjetrën që dëshiron ta shkëpus kontratën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, para se ta lirojë pronën e marrë me qira.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj kontrate dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësi të në tekstin e kësaj kontrate, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendos do të jetë Gjykata kompetente.

Neni 8

Kopja e kontratës


Kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar në 5, (pesë) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 2, (dy) kopje i takojnë secilës palë kontraktuese, kurse (1) një në Drejtorin përkatës.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

PALËT NENSHKRUESE



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA, OPŠTINA PEĆ

SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

I.Broj:01-109206, dana: 28. Decembra 2020.

Na osnovu člana 11 i 12.2 slovo c), vezano za član 17 stav 1 slovo c), Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi ("Službeni List Republike Kosovo, Br.28/2008"), i na osnovu člana 6, tačka 1, podtačka 1.3 Zakona br. 06/L-092 o Davanju Opštinskih Nekretnina na korišćenje i njihovoj razmeni ("Službeni List Republike Kosovo, br.10/2019") u skladu sa članom 7 Pravilnika br.09/2020 o određivanju postupka za davanje opštinskih nekretnina i njihovu razmenu i člana 7, tačka 1.2, člana 13 tačka 1.3, kao i člana 20 tačka 1.3 Statuta Opštine Peć br.01/2020 od dana 30. Septembra 2020, Skupština Opštine Peć na sednici održanoj 28.Decembra 2020 godine nakon postuaka jave diskusije, usvaja ovaj:

PRAVILNIK

Br. 03/2020

O ODREĐIVANJU POSTUPKA DAVANJA OPŠTINSKIH NEKRETNINA NA KORIŠĆENJE NA PERIOD KRAĆI OD GODINU DANA

I. OPŠTE ODREDBE

Član 1

Cilj

Ovim Pravilnikom određuju se kriterijumi, uslovi i postupci davanja opštinskih nekretnina na korišćenje u javnom interesu na period kraći od jedne godine.

Član 2

Oblast primene

Odredbe ovog Pravilnika primenjuju se na opštinske organe, fizička i pravna lica na teritoriji Opštine Peć.

Član 3

Definicije

Izrazi korišćeni u ovom Pravilniku imaju značenje određeno Zakonom Br.06/L-092 o Davanju na Korišćenje i Razmeni Opštinskih Nekretnina.

Član 4

Načela davanja opštinskih nekretnina na korišćenje

1. Davanje opštinskih nekretnina na korišćenje vrši se na osnovu ovih načela:

1.1. Načelo zakonitosti –podrazumeva davanje opštinskih nekretnina na korišćenje i njihovu razmenu na osnovu Ustava, Zakona i drugih podzakonskih akata.

1.2. Načelo efikasnosti –podrazumeva da opštinski organi treba da odvijaju postupak davanja opštinskih nekretnina na korišćenje i njihovu razmenu što brže i sa što manje troškova za Opštinu i stranke, obezbeđujući da cilj davanja na korišćenje bude ispunjavanje javnog interesa i lokalni ekonomski razvoj.

1.3. Načelo jednakog tretiranja stranaka –podrazumeva da se sve stranke u postupku davanja opštinskih nekretnina na korišćenje tretiraju na jednak način, izbegavajući svaku diskriminaciju stranaka i delujući na objektivan i nepristrasan način prema svima;

1.4. Načelo transparentnosti –podrazumevaju da opštinski organi treba da deluju transparentno, da poštuju i garantuju prava stranaka da se informišu o postupcima, uslovima i toku davanja na korišćenje i razmenu opštinskih nekretnina;

1.5. Načelo očuvanja i povećanja vrednosti javne imovine opštine –podrazumeva da korisnik opštinske imovine ima obavezu da imovinu koristi na način da očuva vrednost i da primenjuje sve mere za povećanje ove vrednosti;

1.6. Načelo očuvanja jedinstvenih karakteristika i vrednosti imovine –podrazumeva da korisnik opštinske imovine treba da koristi imovinu samo za određenu namenu, čuvajući njene kulturne, istorijske, arheološke, arhitektonske i ostale vrednosti, kako je predviđeno zakonodavstvom na šnazi.

Član 5

Davanje na opštinskih nekretnina na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine

1. Opštine mogu dati na korišćenje nekretnine na period kraći od 1 (jedne) godine.

2. Nekretnine Opštine koje se mogu dati na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine su sledeće;

2.1 Javni prostori (parkovi, trgovi, bulevari, reklamni panoi);

2.2 Domovi kulture, bioskopi, pozorišta i sportsko-rekreativni tereni;

2.3 Javni prostor ispred lokala

2.4 Lokali u vlasništvu Opštine;

2.5 Javni prostor oko gradilišta.

3. Nadoknada za davanje nekretnina Opštine na korišćenje na period kraći od 1 godine određuje se Opštinskim Pravilnikom o Taksama.

Član 6

Kriterijumi za davanje opštinskih nekretnina na korišćenje

Davanje opštinskih nekretnina na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine vrši se na osnovu sledećih kriterijuma:

- 1.1 Da bude registrovana kao imovina Opštine u opštinske registre imovine;
- 1.2 Da bude oslobođen obaveza od trećih lica;
- 1.3 Da nema neki imovinski spor;
- 1.4 Da bude u skladu sa prostornim planiranjem;
- 1.5 Da ispunjava uslove i kriterijume životne sredine;
- 1.6 Da bude opravdano sa aspekta javnog interesa;
- 1.7 Da utiče na ekonomski razvoj u Opštini.
- 1.8 Da utiče na povećanje vrednosti obrazovne, kulturno-sportske i slične različitosti.

Član 7

Postupak davanja opštinskih nekretnina na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine

1. Opštinske nekretnine daju se na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine svim fizičkim i pravnim licima koje izraze interesovanje preko službenog pismenog zahteva.
2. Zahtev treba da se uputi nadležnom organu i direktoratu:
 - 2.1. Za davanje javnog prostora na korišćenje zahtev se upućuje Direktoratu za Urbanizam;
 - 2.2. Za davanje kulturnih objekata na korišćenje zahtev se upućuje Direktoratu za Kulturu, Omladinu i Sport;
 - 2.3. Za davanje lokala u vlasništvu Opštine na korišćenje zahtev se upućuje direktoratu nadležnom za imovinu.

- 2.4. Za davanje javnih prostora na korišćenje oko radilišta zahtev se upućuje direktoratu za javne usluge.
3. Imovina koja se daje na korišćenje na osnovu zahteva aplikanta treba da se koristi samo za traženu namenu.

Član 8 **Uslovi za apliciranje**

1. Fizička i pravna lica pri apliciranju za dobijanje nekretnina na korišćenje treba da prilože sledeće dokumente:
 - 1.1. Formular ispunjen traženim podacima iz određenog direktorata;
 - 1.2. Kopija lične karte za fizičko lice;
 - 1.3. Certifikat registracije biznisa ili pravnog lica;
 - 1.4. Istorijat biznisa koji aplicira;
 - 1.5. Delatnost koju odvija;
 - 1.6. Idejni projekat;
 - 1.7. Potvrda od Opštine o ispunjenoj obavezi plaćanja poreza na imovinu i opštinskih taksi.
2. U slučaju da dokumentacija kojom se aplicira za davanje opštinskih nekretnina na korišćenje nije kompletirana, zahtev se odbija od strane nadležnog direktorata.

Član 9 **Davanje opštinskih nekretnina na korišćenje organizacijama civilnog društva**

1. Davanje opštinskih nekretnina na korišćenje za organizacije civilnog društva na period kraći od 1 (jedne) godine daje se istim postupkom koji je predviđen pravilnikom.
2. Davanje opštinskih nekretnina organizacijama civilnog društva vrši se u trajanju od 1 (jednog) dana do deset (10) dana, a cilj je obavljanje delatnosti u okviru sopstvenih nadležnosti Opštine, promovisanje kuturnih, arheoloških, sportskih, omladinskih i drugih vrednosti.
3. Organizacijama civilnog društva kojima je cilj obavljanje aktivnosti navedenih u stavu 2 ovog člana nekretnina se daje na korišćenje samo na osnovu zahteva i odobrenja direktora direktorata, izuzimajući razmatranje zahteva od strane komisije za procenu.
4. Organizacijama civilnog društva koje obavljaju rehabilitivne aktivnosti i delatnost za lica sa ograničenim potrebama nekretnine se daju na korišćenje na period kraći od jedne godine na osnovu zahteva i odobrenja direktora direktorata, izuzimajući razmatranje zahteva od strane komisije za procenu.

Član 10 **Osnivanje i sastav Komisije**

1. Gradonačelnik Opštine donosi odluku za svaki direktorat koji na osnovu ovog Pravilnika ima nadležnost i autoritet da daje na korišćenje opštinske nekretnine.

2. Komisija će imati sledeći sastav: od 3 člana Predsedavajući će biti službenik iz Direktorata iz kojeg je upućen zahtev za uzimanje opštinskih nekretnina na korišćenje, a ostala dva člana mogu biti iz drugih direktorata i profesionalnih oblasti.
3. Obaveza komisije je da u roku od 7 dana od podnošenja zahteva izvrši razmatranje zahteva i konstatuje stanje na terenu, da li je u skladu i poklapa li se sa opravdanošću zahteva.
4. Posle razmatranja zahteva, komisija treba da sastavi konačni izveštaj i da preporuči stranku koja je dobitnik.
5. Mandat komisije će biti 2 (dve) godine.

Član 11 **Pravo na žalbu**

1. Nezadovoljna stranka u postupku procene zahteva ima pravo na žalbu Opštinskoj Komisiji za Žalbe u roku od sedam (7) dana od prijema odluke.
2. Gradonačelnik Opštine donosi odluku o osnivanju Komisije za Razmatranje Zahteva;
3. U sastavu Komisije biće 5 (pet) članova, jedan od članova Komisije biće pravnik, a ostali profesionalci iz nadležnih direktorata.
4. Odluka Komisije za žalbe za usvajanje ili odbijanje žalbe je konačna u administrativnom postupku u Opštini.
5. Komisija za žalbe u roku od sedam (7) dana od dana prijema žalbe razmatra žalbu;
6. Stranke nezadovoljne odlukom Komisije za Žalbe u zakonskom roku od 30 (trideset) dana mogu započeti administrativni spor u nadležnom sudu.

Član 12 **Konflikt interesa**

1. Članovi Komisije izuzimaju se iz postupka donošenja odluka ako on ili neki član njegove porodice ima lični ili materijalni interes u vezi davanja opštinskih nekretnina na korišćenje.
2. Članovi Komisije za Procenu izuzimaju se iz postupka procene ako on ili neki član njegove porodice ima lični ili materijalni interes u vezi davanja opštinskih nekretnina na korišćenje.
3. Članovi Komisije za Razmatranje Žalbi izuzimaju se iz postupka procene ako on ili neki član njegove porodice ima lični ili materijalni interes u vezi davanja opštinskih nekretnina na korišćenje.

Član 13 **Potpisivanje ugovora**

1. Na osnovu preporuke komisije za procenu i posle isteka roka za žalbu, Gradonačelnik potpisuje ugovor sa izabranim dobitnikom, a ugovorom se određuju prava i obaveze ugovornih stranaka.
2. Pravo na korišćenje opštinskih nekretnina na period kraći od jedne godine ne može se preneti trećim licima.

II. POSEBNE ODREDBE

Član 14 **Nadgledanje ugovora**

1. Nadležni direktorat vrši nadgledanje ostvarivanja ugovora i da li stranka koristi imovinu prema uslovima ugovora.
2. U slučaju neispunjavanja ugovora ili izbegavanja cilja zbog kog je imovina data na korišćenje na zahtev stranke, nadležni direktorat će pripremiti konačni izveštaj kojim će preporučiti Gradonačelniku Opštine jednostrani raskid ugovora.
3. Gradonačelnik Opštine posle razmatranja konačnog izveštaja pripremljenog od nadležnog direktorata i na osnovu date preporuke raskida ugovor jednostrano, obaveštavajući 7 (sedam) dana ranije ugovornu stranku.
4. Opština ima obavezu da objavi listu imovina koje su date na korišćenje na period kraći od 1 (jedne) godine prema odredbama ovog Pravilnika.
5. Objavljivanje liste nekretnina Opštine koje se daju na korišćenje u roku od 7 (sedam) dana od potpisivanja ugovora.

Član 15 **Održavanje opštinske imovine**

1. Svi korisnici Opštinske imovine imaju obavezu da je održavaju i da je koriste na način određen ugovorom o korišćenju;
2. Fizička i pravna lica i svi korisnici nekretnina Opštine imaju obavezu da se brinu o njoj i da je štite, kako je predviđeno ovim Pravilnikom.

III. PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE

Član 16 **Stavljanje van snage**

1. Stupanjem na snagu ovog Pravilnika stavljaју se van snage Pravilnici i odluke Skupštine Opštine koje su u suprotnosti sa odredbama ovog Pravilnika.

Član 17
Konflikt sa zakonom


1. U slučajevima nepoklapanja odredbi ovog pravilnika sa zakonskim odredbama i drugim podzakonskim aktima, primeniće se odredbe zakona i drugih pozakonskih akata koje se primenjuju u Republici Kosovo.

Član 18
Primena

1. Za primenu ovog Pravilnika zadužen je Gradonačelnik Opštine i direktori Direktorata u Opštini Peć.

Član 19
Stupanje na snagu

1. Nakon usvajanja od strane Skupštine Opštine Peć, ovaj Pravilnik stupa na snagu 15 dana posle slanja nadležnom autoritetu u smislu člana 81, Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi "Službeni List Republike Kosovo br.28/2008", člana 8 vezano za član 9 Pravilnika broj 01/2019 o postupku sastavljanja i objavljivanja opštinskih akata i posle objavljivanja na obaveštajnoj tabli Opštine.



PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
Dr. Islam Husaj



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

Na osnovu člana 13. Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi (Službeni List Republike Kosovo br. 28 /15 Juna 2008), i člana 52 Statuta Opštine Peć, br. 01/2020 od 30. septembra 2020, na osnovu člana 10. Pravilnika () br. /2020 za određivanje postupka davanja opštinskih nekretnosti na korišćenje na period kraći od jedne godine Gradonačelnik Opštine donosi ovu:

**ODLUKU
O FORMIRANJU KOMISIJE ZA ŽALBE**

1. Formira se komisija za razmatranje žalbi podnetih protiv odluke procene zahteva od fizičkih i pravnih lica za dobijanje nepokretne imovine opštine na korišćenje u sledećem sastavu:

- | | |
|-----|--------------------|
| 1.1 | Predsedavajući/ća; |
| 1.2 | Član/ica; |
| 1.3 | Član/ica; |
| 1.4 | Član/ica; |
| 1.5 | Član/ica; |

1. Dužnost i odgovornost komisije za razmatranje žalbi je da odluči u vezi žalbi podnetih protiv postupka procene zahteva podnetih od fizičkih i pravnih lica za uzimanje nepokretne imovine Opštine na korišćenje.
2. Mandat komisije je dve (2) godine;
3. Ova odluka stupa na snagu na dan potpisivanja od strane Gradonačelnika Opštine.

Gradonačelnik Opštine



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Na osnovu člana 5, tačka ----, vezano sa članom 6, Pravilnika Br. (-----), za definisanje postupaka o davanju na korišćenje Opštinskih nekretnina na period kraći od jedne godine (1) i konačni Izveštaj komisije 01-Br-----, od ----- za razmatranje i procenu zahteva za davanje u korišćenje Opštinske nekretnine na period kraći od jedne godine, Gradonačelnik Opštine sklapa ovaj:

UGOVOR

O davanju nekretnina Opštine Peć na korišćenje na period kraćod jedne godine

Sastavljeno dana ----- u -----, između sledećih ugovornih strana:

I. UGOVORNE STRANE:

1. Gradonačelnik Opštine, koji zastupa Opštinu Peć, kao davalac nekretnine Opštine na korišćenje na period kraći od jedne godine na jednoj strani,

2. g. ----- iz naselja/ sela ----- Opština -----, sa brojem ličnekarte -----, dobitnik-korisnik nekretnine Opštine, na drugoj strani.

Član 1
Predmet ugovora

Predmet ovog ugovora je davanje nekretnina Opštine Peć na period kraćod jedne godine (1), katastarska parcela Br, -----, prema posedovnom listu br.-----, dana -----, katastarska parcela "-----", mesto zvano "-----", evidentirana kao imovina Skupštine Opštine -----, sa ukupnom površinom -----m², sakorišćenjem ----- karaktera, prema zahtevu stranke.

Član 2
Trajanje ugovora

Ugovorne stranke su se složile da rok korišćenja gorenavedene parcele bude ----- dana/meseci, od dana potpisa ugovora 01-Br-----, dana-----.

1. Nakon isteka roka predviđenim u tački 1, člana 2, ovog ugovora ili prevremenom prekidu ugovora, pravo na korišćenje se vraća vlasniku Opštine Peć;

Član 3

Visina cene i rok plaćanja

1. Cena za dnevni/mesečni je određena u iznosu od 0.00€ za m², koji je određen prema Pravilniku o Opštinskim Taksama sa brojem 01/2019 o Opštinskim Teretima i Kaznama od dana 30. Aprila 2019 sa br. protokola 060/01-165075 dana 30. Aprila 2019.
2. Korisnik se obavezuje da plaćanje u _____ dobijeno na korišćenje uplati na račun _____ Opštine Peć, na početku svakog meseca, od _____ najdalje do _____ narednog meseca.
3. U slučaju neplaćanja duga, prema korisniku će se preduzeti kaznene mere, u skladu sa važećim zakonskim procedurama, uračunavajući i kamate.
4. Pravo na korišćenje nekretnine Opštine ne može se preneti na korišćenje trećim licima od zakupca.

Član 4

Davanje nekretnine i način korišćenja

1. Opština garantuje da predmet ovog ugovora nema pravnih nedostataka.
2. Opština je dužna da za imovinu koja je data na korišćenje u katastarske knjige evidentira pravo korišćenja sve dok traje ovaj ugovor.
3. Korisnik ne može promijeniti vršenje svoje delatnosti, a imovinu koju je dobio na korišćenje mora koristiti samo u svrhu predviđenu ovim ugovorom.

Član 5

Nadgledanje ugovora

1. Nekretnina ne menja pravnog titulara, njen vlasnik ostaje Skupština Opština Peć i kao takva ne može se preneti trećem licu na korišćenje, ne može se otuđiti, ne može biti predmet poreskog tereta ili bilo kog drugog teret na ovu imovinu.
2. Nadležni direktorat nadgleda realizaciju ovog ugovora.

Član 6
Jednostrani raskid ugovora

1. Jednostrani raskid ugovora vrši se u slučaju neispunjavanja obaveza od strane korisnika nekretnine, kako je određeno u ovom ugovoru.
2. U slučaju raskida ugovora pre isteka roka, uz saglasnost ugovornih strana, preostale obaveze će se urediti posebnim sporazumom između ugovornih strana, ali obavještavajući jedni druge da žele raskinuti ugovor u roku od 15 (petnaest) dana pre nego što napusti zakupljenu imovinu.

Član 7
Rešavanje nesporazuma

Stranke se obavezuju da će se pridržavati ovog ugovora i da se u slučaju eventualnog spora ili nejasnoća u tekstu ovog ugovora nesporazum reši razgovorom, prijateljskim konsultacijama i sa razumevanjem, u suprotnom će za odlučivanje biti nadležni Sud.

Član 8
Kopija ugovora

Ovaj je ugovor sastavljen i potpisan u 5 (pet) identičnih kopija, od kojih dve (2) kopije pripadaju svakoj ugovornoj strani, dok (1) je jedan za nadležni Direktorat.

Član 9
Stupanje na snagu

Ovaj ugovor stupa na snagu na dan potpisivanja od strane ugovornih strana.

POTPISNE STRANE
